

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall
PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: Furnizim vendosje sistem sigurie dhe sistem survejimi, ndërtimi i rrjetit të brëndshëm kompjuterik për zyrat e Qendrës multifunkionale të qytetit Ersekë ,Bashkia Kolonjë viti 2024.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

32573000-0 - Sistemi i kontrollit të komunikimit,
35125000-6 - Sistemit të mbikqyrjes,
35125300-2 - Kamera sigurie,
32235000-9 - Sistem survejimi me qark të mbyllur,
32412110-8 - Rrjeti internet

VLERA E FONDIT LIMIT: 2,997,927 (Dymilionenëntëqindënëntëdhjetëeshatëmijëenëntëqind enjëzetëeshtatë) lekë pa tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.**162/2020** “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c i ndryshuar me ligjin nr.**16** datë.**08.02.2024** dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. **285**, datë **19.05.2021**“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Kolonjë** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;*
- b. *Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 8*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Kërkesat e mësipërme bazohen me Nenin 76 “Kriteret detyruese për skualifikim” Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 ”Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” , i ndryshuar me ligjin nr.**16** datë.**08.02.2024** si dhe në mbështetje të Nenit 26 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik:

Neni 82, i LPP “1. *Bashke me dorezimin e kerkesave per pjesemarrje ose te ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojne si prove paraprake ne vend te disa vertetimeve te leshuara nga autoritetet publike ose pale te treta, formularin permbledhes te vetdeklarimit, sipas parashikimeve te ketij ligji. Permbajtja e ketij formulari percaktohet ne rregullat e prokurimit publik*”.

Neni 83 i LPP “*Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël*”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas percaktimeve të bëra në Shtojcën 7 të DST-ve (**Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/Kualifikimit**).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

(shënim: *plotësoni nëse është rasti, aktin konkret ligjor ose nëligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale në fjalë*).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatori/et ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2021-2022-2023**, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet**.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në **nenin 77 pika 3 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”,** , i ndryshuar me ligjin nr.16 datë.08.02.2024 ku parashikohet se: *“Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën”, “Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës”.*

si dhe bazuar në nenin 43, pika 2/c, nenin 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet se:

“Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

c) 40 % të vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit nënkufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”.

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zotëron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

Duke marrë në konsideratë vlerën e fondit limit të kësaj procedure prokurimi, kërkohet që OE ofertues të paraqesë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë në kohë dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Për këtë, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qëllim, është argumentuar se vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit** dhe vendosja e këtij limiti nuk kufizon pjesëmarrjen e operatoreve ekonomike.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Kjo është një kërkesë e cila nuk e pengon konkurrencën dhe është e bazuar në garancinë që ofertuesi i paraqet Autoritetit Kontraktor.

Autoriteti Kontraktor në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda **datës 31 mars të vitit pasardhës**, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.” pasi tatimpaguesit (operatorët ekonomikë) kanë detyrimin të dorëzojnë në administratën tatimore brenda **datës 31 mars të vitit pasardhës** bilancin kontabël së bashku me anekset e tij, si dhe Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar në rastet kur plotësohen kushtet e parashikuara nga ligji.

2.2.2 Operatori/et ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2021-2022-2023**, të çertifikuara nga autoritetet përkatëse, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve neni 41, pika ”c”, të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar. Në zbatim të nenit 43, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk kanë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda **datës 31 mars të vitit pasardhës**, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhëne tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

2.2.3 Operatori/et ekonomikë ofertues duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për të gjitha vendet ku operatori ushtron aktivitetet **për vitin 2023** (Sipas QKB) sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore **dhe për vitin e fundit 2024 (këstet e maturuara)**.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimevetë nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar , përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, , i ndryshuar me ligjin nr.16 datë.08.02.2024 si dhe nenit 43, nenit 41, pika 5/ c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe ne ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar,në ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, në ligjin nr.131/2015 “Për QKB” i ndryshuar, si dhe në ligjin nr.9723 date 03.05.2007 “Për QKR” i ndryshuar.

Meqënëse operatorët ekonomik kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likjuar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, **në një vlerë jo më të vogël se 20 %** të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit ,nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” , i ndryshuar me ligjin nr.16 datë.08.02.2024 dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe rekomandimit Nr.17971 Prot.datë.10.03.2022 të agjensisë së prokurimit publik.Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë **në një vlerë jo më të madhe se 20 %** të vlerës së fondit limit,që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

Në zbatim të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar nenit 55, pika 4, germa b) në vlerën 20% të fondit limit.

Duke marrë në konsideratë vlerën e fondit limit të kërkuar objekt procedure prokurimi, është menduar se vlera e kërkuar që OE ofertues të ketë realizuar kontrata të ngjashme, të jetë afër limitit maksimal të lejuar dhe në këtë mënyrë, AK ka sigurinë dhe besueshmërinë që OE ofertues mund të realizojë kontratën objekt prokurimi pa patur pengesa të ndryshme që do të ndikonin në ecurinë e punës së AK.

Kontrata e ngjashme është e domosdoshme për të vertetuar eksperiencën e operatoreve ekonomik ofertues, me qëllim që të garantohet zbatimi i kontratës me sukses.

2.3.2. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojnë personelin kryesor teknik si mëposhtë:

a. 1 (një) inxhinier elektronik

Për të cilin duhet të paraqiten:

- Kontratë individuale të punës
- Diplomë ose çertifikatë
- Të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë **minimalisht për muajin e fundit.**

b. 1 (një) specialist të çertifikuar për network në nivel Profesional CCNP ose ekuivalent

Për të cilin duhet të paraqiten:

- Kontratë individuale të punës
- Diplomë ose çertifikatë
- Të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë **minimalisht për muajin e fundit.**

c. 1 (një) specialist të çertifikuar nga prodhuesi i pajisjeve CCTV të ofertuara për instalimin dhe menaxhimin e sistemeve video ose ekuivalent

Për të cilin duhet të paraqiten:

- Kontratë individuale të punës
- Diplomë ose çertifikatë
- Të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë **minimalisht për muajin e fundit.**

(Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike ky kriter plotësohet nga secili anetar i bashkimit, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes të përcaktuara në akt marrëveshje).

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar , përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të neni 4 pika 18 , pikës 4 të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar me ligjin nr.16 datë.08.02.2024, dhe nenit 40, pika 5/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që kontraktuesi duhet të përcaktojë personelin kryesor teknik për kryerjen e shërbimeve të cilët kanë një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e punimeve pasi ata janë përgjegjës për zbatimin e objektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij. Kjo kontrate publike përfshin blerjen (hyrjen në magazine të mallit) me pas vendosjen dhe instalimin.

Dokumentacioni plotësues i kërkuar në kriteret e veçanta për kualifikim pjesë përbërëse e dokumentave të tenderit, sikundër janë, kontratë pune e vlefshme, diploma etj janë vendosur për arsye se me paraqitjen e këtij dokumentacioni vërtetohet se ky personel kryesor teknik është operativ pranë Ofertuesve të mundshëm dhe në këtë mënyrë Autoriteti Kontraktor krijon bindjen se Operatorët ekonomikë pjesëmarrës zotërojnë personelin e nevojshëm për realizimin me sukses të objektit që prokurohet. Stafi teknik i kualifikuar është kërkuar në raport me shërbimet që kërkohen të realizohen etj. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij punonjës të aftë profesionalisht për realizimin e objektit.

- a. Për kriterin në pikën **2.3.2** gërma **a**, 1 (një) **inxhinier elektronik** gjykohet se është i domosdoshëm në kushtet e madhësisë dhe kompleksitetit të realizimit të kontratës si furnizim+vendosje, kohëzgjatjes të saj dhe rëndësisë së zgjidhjes së saktë teknologjike për instalimin e mbikeqyrjen e sistemeve të reja, ku të gjitha këto duhet domosdoshmerisht të ndiqen nga të paktën 1 (një) profesionist të kualifikuar inxhinierik elektronik nga fillimi (nënshkrimi i kontratës) deri në përfundim të saj, në mënyrë që të minimizohet në maksimum risku vendosjeve teknologjike të pasakta, mosfunksionimit të sistemit për qëllimet e tij, duke pasur parasysh dhe shtrirjen në disa ambiente të jashtme dhe godinën qendrore që përbën një kompleksitet teknologjik më vete. Gjithashtu shërbejnë dhe për zbatimin e kushteve të garancisë për produktet dhe sistemin e ri që prokurohet.
- b. Për kriterin në pikën **2.3.2** gërma **b**, 1 (një) **specialist të çertifikuar për network në nivel Profesional CCNP ose ekuivalent** është shumë i rëndësishëm pasi sistemi i sigurisë ka një rrjet komunikimi network të zgjeruar, i cili kërkon kompetenca të larta teknike në nivel profesional për konfigurimin, administrimin dhe monitorimin e rrjetit network. Për këtë kërkohet që instalimi të bëhet nga të paktën një specialist profesionist i kualifikuar e i çertifikuar sipas nivelit të mirënjohur "CCNP" ose ekuivalent i tij.
- c. Për kriterin në pikën **2.3.2** gërma **c**, 1 (një) **specialist të çertifikuar nga prodhuesi i pajisjeve CCTV të ofertuara për instalimin dhe menaxhimin e sistemeve video ose ekuivalent**, gjykohet se është i domosdoshëm në kushtet e madhësisë, kompleksitetit të realizimit të kontratës si furnizim+vendosje për sistemet CCTV, kohëzgjatjes të saj dhe rëndësisë që ka instalimi e konfigurimi i saktë dhe kompetent nga pikëpamja softuerike sipas udhëzimit të prodhuesit respektiv, ku procesi duhet domosdoshmerisht të ndiqet nga të paktën 1 (një) specialist i çertifikuar nga prodhuesi respektiv për menaxhimin e sistemeve video, nga fillimi (nënshkrimi i kontratës) deri në përfundim të saj, në mënyrë që të minimizohet në maksimum risku i difekteve apo mos sinkronizimeve të sinjaleve CCTV dhe që sistemi të shërbejë për qëllimet e tij.

2.3.3 Operatori/et ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore **minimalisht 10 (Dhjetë) persona për muajin e fundit**, të vërtetuar me:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, **për muajin e fundit**.
- Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi **për muajin e fundit**.

(Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike ky kriter plotësohet nga secili anetar i bashkimit, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes të përcaktuara në akt marrëveshje).

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar , përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kjo kërkesë për stafin mbështetës është përcaktuar bazuar në nenin 77, të pikës 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenin 40, pika 5, gërma b,c të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Vendosja e këtij kriteri për fuqinë punëtore **minimalisht 10 (Dhjetë) persona për muajin e fundit** është bërë në përputhje me zerat dhe volumet e preventivit, që është përlllogaritur për zbatimin e kësaj kontrate.Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të shërbimit. Kërkesa e stafit mbështetës është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e kontratës.

2.3.4 Operatori/et ekonomik në rast se nuk janë prodhues duhet të paraqesin për shitjen e të gjitha produkteve të kërkuara **vërtetim** ose **deklaratë** ose **autorizim nga prodhuesi**, ose **nga distributor i autorizuar prej prodhuesit**, vërtetuar me marrëveshje bashkëpunimi (ose ekuivalenti i tij/saj) e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis **ofertuesit - distributor-prodhues**, ku ky i fundit duhet të përmbajë të dhëna të plota si: telefon, e-mail, website, etj, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi.(Nëse dokumentacioni është në gjuhë të huaj duhet e përkthyer dhe noterizuar **si dëshmi e vërtetësisë dhe saktësisë së përkthimit**) .

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në përputhje me nenin 77 e LPP, si dhe nenin 40, pika 5,6,8 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, është gjykuar si kriter i domosdoshme, pasi ka të bëjë me informacion e nevojshem se ku prodhohet malli dhe mundësinë reale për të bërë furnizimin , nëpërmjet autorizimit që i jepet operatorit ekonomik ofertues.

Referuar **nenit 77 pika 4** të ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht:

“Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

Ndërsa në **nenin 92, pika 3** të ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “**Për prokurimin publik**”, parashikohet:

“Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit”.

Kriteri i përcaktuar mbi paraqitjen e **vërtetim** ose **deklaratë** ose **autorizim nga prodhuesi, ose nga distributor i autorizuar prej prodhuesit**, për të gjitha produktet e kërkuara është në përputhje dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës si dhe në përputhje me dispozitat ligjore të sipërcituara. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantojë se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë origjinalitetin e mallrave të furnizuara, si dhe përfshirjen e vet shërbimeve dhe suportit të prodhuesit në projekt, përmes vet atij apo distributorit të autorizuar.

Vërtetim ose **deklaratë** ose **autorizim nga prodhuesi, ose nga distributor i autorizuar prej prodhuesit** është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon kanalin zyrtar të origjinës së produkteve/licensimeve/suporteve specifike të garancise 12 mujore që kërkohen në procedurë, na garanton gjithashtu se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek autoriteti kontraktor të këtyre produkteve/softeve-programeve me license. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të produkteve / softeve-programeve që kërkohen të blihen e që janë prodhuar/krijuar sipas standardeve bashkekohore nga prodhues me fame të mirë botërore dhe të zyrtarizuar në praktikat e tyre të veprimtarisë tregtare. Ky kriter është jo diskriminues, pasi është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues dhe për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve tekniko-profesionale të OE-së për përmbushjen me sukses të kontratës, duke vërtetuar se disponojnë autorizimet përkatëse për furnizimin e instalimin/kolaudimin e produkteve/softeve aplikative, objekt i kontratës, të lëshuara nga prodhuesit/distributorët përkatës si dhe që do vijojnë për të zbatuar kushtet e mirëmbajtjes e të garancisë sipas afatit të përcaktuar në dokumentat e tenderit.

2.3.5 Në datën dhe orën e hapjes së procedurës operatori/et ekonomik duhet të paraqes/in nga një mostër në ambientet e AK vetëm për artikujt WiFiAcces Point,Kamera IP Indoor,Kamera IP Indoor AI,Kamera IP Outdoor,Kamera IP Outdoor AI,Network Video Recorder,Switch imenaxhueshem 24 Porta L2,Switch imenaxhueshem 16 Porta PoE,Router,UPS per rack 9U,UPS per rack 22U, **sipas preventivit bashkëngjitur, pranë Bashkisë Kolonjë** për procedurën: “**Furnizim vendosje sistem sigurie dhe sistemurvejimi, ndërtimi i rrjetit të brëndshëm kompjuterik për zyrat e Qendrës multifunksionale të qytetit Ersekë ,Bashkia Kolonjë viti 2024**”.

- Mostrat e kërkuara duhet të kenë një etiketë të ngjitur, e cila do të përmbajë: **mostër** “emri i artikullit”, datën e zhvillimit të tenderit, emrin e ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e Operatorit Ekonomik.
- Mostrat duhet të jenë në përputhje me të gjitha specifikimet teknike të kërkuara në DST dhe të njëjta me ato të ofruara nga operatori ekonomik ofertues në dokumentacionin teknik të paraqitur në sistem (SPE). Mosparaqitja e mostrave, dorazi, në ditën e hapjes së ofertave është kusht s’kualifikues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në përputhje me nenin 40, pika 6 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, dhe është gjykuar si kriter i domosdoshme, pasi ka të bëjë me informacione të nevojshme mbi karakteristikat e mallrave, duke garantuar përmbushjen e specifikimeve teknike të cilat të jenë identike në momentin e dorëzimit të të gjithë mallit.

Referuar **nenit 40, pika 6** të VKM nr. **285**, datë 19.05.2021 “**Për miratimin e rregullave të prokurimit publik**”, parashikohet shprehimisht:

Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial 39 tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose **b)** fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose

c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

Produktet e kërkuara si mostër për autoriteti kontraktor është një kriter që përforcon bindjen nëse specifikimet teknike janë të sakta ose jo, cilësinë dhe origjinalitetin e produkteve që do ofrojnë dhe realisht do dorëzojë e instaloje/vendose operatori ekonomik fitues, në mënyrë që të minimizohet në maksimum mundësia për abuzime gjatë zbatimit të kontratës.

Duke qënë se pjesë e objektit të kësaj procedure janë edhe blerja e instalimi i sistemeve Network/Wi-Fi dhe CCTV me qëllime të rëndësishme, autoriteti kontraktor kërkon të sigurohet për cilësinë dhe origjinalitetin e komponenteve thelbësor të këtyre sistemeve.

2.3.6 Operatori/et ekonomik duhet të paraqes-in certifikatat e mëposhtme:

- ✓ Çertifikate për sistemin e menaxhimit të cilësisë **ISO 9001:2015** ose ekuivalente, (e vlefshme) e cila të përfshijë objektin e prokurimit .
- ✓ Çertifikate për sistemin e menaxhimit të shërbimeve **ISO 20000-1:2018** ose ekuivalente, (e vlefshme) e cila të përfshijë objektin e prokurimit .
- ✓ Çertifikate për sistemin e menaxhimit të informacionit **ISO 27001:2022** ose ekuivalente, (e vlefshme) e cila të përfshijë objektin e prokurimit .

Në rastet e bashkimit të operatoreve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë këto certifikata (ose ekuivalente) (të vlefshme), në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes të zërave që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt-marrëveshjes).

Autoriteti kontraktor do të pranojë edhe mundësinë e paraqitjes së standardit SSH/EN; SSH/ISO mbi konformitetin e standardit european apo atij ISO, dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

VO: Nëse certifikatat nuk janë në gjuhën shqipe të jenë të përkthyer dhe të noterizuara si dëshmi e vërtetësisë dhe saktësisë së përkthimit .

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 39, 44, pika 1 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.Për vet natyrën e veçantë, vendndodhjes së objektit të kontratës,që do të prokurohet dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë.Sistemi i menaxhimit të cilësië, menaxhimit të shërbimeve, dhe menaxhimit të informacionit në punë janë standarte që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit, si dhe është proporcional me këtë objekt pasi totalisht mallrat janë të natyrës TIK.

Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përse kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatoreve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.

Certifikimi **ISO 9001:2015** ose **ekuivalent** shërben për të verifikuar dhe garantuar që OE i interesuar është në gjendje të kryejë realizimin e kontratës në fjalë në mënyrë cilësore dhe të plotë, bazuar në organizimin e brëndshëm për menaxhimin sa më të mirë të cilësisë implementuese, meqënëse është edhe furnizim-vendosje.

Certifikimi **ISO 20000-1:2018** ose **ekuivalent** shërben për të verifikuar dhe garantuar që OE i interesuar është në gjendje të kryejë realizimin e kontratës në fjalë duke qënë se zotëron një sistem menaxhimi për shërbimet e teknologjisë së informacionit, duke pasur më shumë garanci që ky i fundit të zbatohet të gjithë sistemin në tërësi i cili është tërësisht i bazuar në produkte TIK, meqënëse është edhe furnizim-vendosje.

Certifikimi **ISO 27001:2022** ose **ekuivalent** shërben për të verifikuar dhe garantuar që OE i interesuar është në gjendje të kryejë realizimin e kontratës në fjalë duke siguruar që informacionet të menaxhohen në mënyrë të sigurt nga pikëpamja informatike dhe të jenë të kontrolluara, si dhe aksesit mbi to të jetë i verifikueshëm e i kodifikuar, dhe kjo kërkon kompetencë të shtuar profesionale në këtë drejtim, meqënëse është edhe furnizim-vendosje.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet Teknike dhe termat e referencës për procedurën respektive janë hartuar nga komisioni i Përgatitjes së specifikimeve teknike, termat e referencës dhe përlogaritjes së fondit limit i ngritur me urdhër nr.249 me nr.2179 prot, datë.09.05.2024, pjesë përbërëse e strukturës së **Bashkisë Kolonjë**, në përputhje me nenin 36, të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar me ligjin nr.16 datë.08.02.2024 si dhe nenit 76 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Specifikimet Teknike dhe termat e referencës janë pjesë e setit të dokumentave të ngarkuara në SPE për procedurën respektive.

Fondi Limit i përlogaritur për këtë procedurë është hartuar në përputhje me nenin 34 dhe 35 të ligjit Nr.162/2020 datë.23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar me ligjin nr.16 datë.08.02.2024 si dhe neni 76 i Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285 datë.19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, nga komisioni i Përgatitjes së specifikimeve teknike, termat e referencës dhe përlogaritjes së fondit limit i ngritur me urdhër nr.249 me nr.2179 prot, datë.09.05.2024, pjesë përbërëse e strukturës së Bashkisë Kolonjë.

***Shënim:** Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

***Kujdes:** Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

Në përfundim, Njësia e Prokurimit vendosi unanimisht miratimin e dokumenteve të tenderit dhe si afat përfundimtar për dorëzimin e ofertave përcaktoi datën **05.06.2024, ora 11:00**.

Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt: **“Furnizim vendosje sistem sigurie dhe sistem survejimi, ndërtimi i rrjetit të brëndshëm kompjuterik për zyrat e Qendrës multifunkionale të qytetit Ersekë ,Bashkia Kolonjë viti 2024”**, Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurimin anëtar në NJP.

Bashkëlidhur këtij proces-verbali:

- Dokumentat e tenderit
- Preventivi
- Specifikimet teknike.

Njësia e Prokurimit